

Statuti dhe Akt themelimi

i

Shoqerise ECO CASA

Kapitulli I

Ne mbeshtetje te ligjit nr.9901 date 14.04.2008, "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" dhe Ligjit nr.9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit" (I ndryshuar) qe rregullojnë marredhenjet tregtare dhe funksionimin e shoqerive.

Themeluesi

Sot me date 21.07.2023, ne themeluesit, Cherubino Battaglia, i biri i Carmine lindur me 29.04.1964 ne Rome Itali, me nr.pasaporte YB2061300, banues ne Corso Primo Maggio 45 Ferrara Itali dhe Sokol Dallaku, i biri i Mehdi-ut, lindur me 17.07.1986 ne Kruje, i pajisur me nr.pasaporte BD1369982 dhe nr.personal I60717016O me zotesi te plete per te vepruar,banues ne Via Alcide de Gasperi 9 Monte San Pietro , Bologna tel, 00355 67 60 54 632

Kreu I

Objekti, emertimi, selia, rregjimi juridik, afatet

Shoqeria "ECO CASA" sh.p.k, nepermjet ketij Statuti dhe Akt Themelimi per krijimin e saj, bazuar ne legjislacionin shqiptar ne fuqi, rregullon gjendjen juridike te shoqerise, marredhenjet e saj me te tretet, te dhenat me rendesi per poziten juridike te ortakeve ne raport me shoqerine dhe me te tretet, organet drejtuese dhe kompetencat e tyre, organizimin dhe objektin e veprimtarise se shoqerise si dhe ceshtje te tjera per mbarevajtjen e shoqerise "ECO CASA" sh.p.k cdo ceshtje qe nuk eshte e shprehur ne kete statut dhe akt themelimi do te interpretohet ne perputhje me frymen e tij nisur nga parimet e mirebesimit, bashkepunimit dhe interesit reciprok te ortakeve te shoqerise

Neni 1

1.1 Objekti I veprimtarise se shoqerise , ne perputhje me legjislacionin shqiptar do te jete:

Grumbullim, transportim dhe depozitimi i dherave dhe mbejtjeve te llojeve te ndryshme urbane. Import-Eksport te materialeve dhe pajisjeve te ndryshme elektromekanike te çdo lloji ne funksion te (digave , hidrocentraleve,nenstacioneve etj) si dhe tregtimin e tyre me shumice dhe pakice brenda dhe jashte vendit, dhenien e asistences teknike per mirembajtjen, riparimin, prodhimin dhe instalimin e pajisjeve dhe te çdo materiali tjeter ndihmes te sistemit dhe rrjetit elektrik. Import-eksport, shitblerje energjie. Punime dhe instalime te ndryshme elektrike dhe mekanike. Projektimin, montimin dhe mirembajtjen e impianteve te prodhimit dhe shperndarjes se energjise. Sherbime te ndryshme dhe punime sherbimesh ne te gjitha

fushat sipas shperndarjes se energjise. Prodhim dhe tregtim me shumice dhe pakice te materialeve te ndryshme elektrike dhe pajisjeve te tyre etj, te materialeve te ndryshme te ndertimit , si dyer, dritare , etj, te materialeve te ndryshme. Aktivitet, ne fushen e ndertimit si: ndertime te reja, ujesjelles-kanalizime, ndertimin e ndertesave publike dhe private , meremetime, mirembajtje , rikonstruksione etj. Aktivitet ne fushen e transportit, mjedisit, prodhimit, sherbimeve te ndryshme, artikuj industrial, tregtise dhe telekomunikacionit. Aktivitet ne hartimin e raporteve te vleresimit te ndikimit ne mjedis, auditim mjedisor, ekspertiza per probleme mjedisore, ekspertiza per te vleresuar rezultatet e nje auditimi mjedisor, sherbime profesionale lidhur me ndikimin ne mjedis, hartimin e projekteve te ndryshme ne 2 fushen e mbrojtjes se mjedisit etj. Import-eksport i mallrave te ndryshme industriale dhe ushqimore, perdom shtepiak, si detergjente, supermarket, tregetim i te gjitha materialeve, tregtim mallrash me shumice dhe pakice, tregetim te artikujve kancelarie te te gjitha llojeve, paisje elektrike, elektronike, kompjuterike te te gjitha llojeve te kesaj fushe, prodhime te gjitha llojeve, konsulence ne te gjitha fushat, restorante bar bufe, reklamime, sponsorizime te ndryshme, shkembime valutore, botime periodike, koncesione te te gjitha fushave, aktivitete arsimore, ngritje profesionale, trajnime, jape dhe marre me qera ambjente te ndryshme, te shfrytezoje ambjente per qellime vetjake dhe per te tretet, studimin, projektimin, konsulencen, supermarjen zbatuese dhe/ose jopublike te veprave me karakter shfrytezimi dhe/ose administrimi publik dhe/ose privat si: ndertimin e ndertesave publike dhe private, rrugeve, urave, tuneleve, mbikalimeve dhe nenkalimeve, autostradave etj. Studim, projektim, ndertim e zbatim te veprave ndertimore te te gjitha llojeve sipas legjisacionit shqiptar. Kultivimin e tokave bujqesore, ne pronesi te shoqerise ose te poseduara nga shoqeria, pavaresisht titullit te posedimit, prodhimin e veres (vitikultura), mbjelljen dhe rritjen e pemeve (silvikultura), mbareshtimin e kafsheve dhe vecanerisht bagetive dhe shpendeve: si dhe kryerjen e cdo veprimtarie qe lidhet manipulimin, ruajtjen, transformimin dhe tregtimin e produkteve te shoqerise, qe kane si objekt produktet e perftuara kryesisht nga bujqesia, pemtaria ose blegtoria, si edhe cdo veprintari qe lidhet me furnizimin e mallrave ose sherbimeve kryesisht nepermjet perdomit te pajisjeve ose burimeve te shoqerise qe zakonisht perdoren per kryerjen e veprimtarive bujqesore apo blegtore. Stabilizimin e rreshqitjeve te tokes. Hoteleri turizem.

Neni 2

Emertimi dhe selia juridike e shoqerise

2.1 Emertimi i shoqerise "ECO CASA" sh.p.k

2.2 Selia juridike e shoqerise ndodhet ne adresen: Rruga LORD BEACONSFIELD,
Yzberisht,NJ.A. Kashar,objekti 1, VILA-L, AP.nr.17,shkalla 1,kati trete, Tirane.

2.3 Shoqeria mund te krijoje filiale, zyra perfaqesimi e agjensi ne qytete te tjera te Shqiperise ose jashte vendit

2.4 Adresa e ortakeve ne marredhenje me Shoqerine do te jetë ajo qe rezulton e shenuar ne librin e Shoqerise

Neni 3

Regjimi Juridik

3.1 Forma juridike e shoqerise eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar. Vemprimtaria e saj I nenshtrohet dispozitave te ketij statute dhe akt themelimi, si dhe legislacioni ne fuqi. Ligji I aplikueshem per zgjidhjen e cdo mosmarreveshje eventuale qe lind gjate aktivitetit te shoqerise eshte ligji shqiptar.

3.2 Kompetente per zgjidhjen e mosmarreveshjeve te parashikuara ne paragrin e mesiperm eshte Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

3.3 Me vendimin unanim, Ortaku mund te ndryshojhe rregjimin juridik te Shoqerise , ne qofte se ne te ardhmen krijohen premise me te favorshme per funksionimin e saj.

3.4 Shoqeria gezon personalitet juridik nga data e rregjistrimit te saj ne QKB

Neni 4

Kohezgjatja

4.1 Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise eshte e pacaktuar

KREU II

Organet drejtuese, marrja e vendimeve, administrimi dhe kontrolli I shoqerise , ekspertet

Neni 5

Organet drejtuese

Organet drejtuese te Shoqerise tregtare “ECO CASA” sh.p.k jane:

- 1) Asambleja e Pergjithshme e cila eshte organi me I larte vendimarres
- 2) Administratori I Shoqerise, qe caktohet nga Asambleja e pergjithshme

Neni 6

Marrja e vendimeve

6.1 Asambleja, rregullisht e thirrur dhe e perbere prej ortakeve te shoqerise, perfaqeson vullnetin e ortakeve. Vendimet e marra prej saj, per sa kohe jane te vlefshme ne perputhje me ligjin dhe me kete statut, detyrojne te gjithe anetaret e asamblese edhe pse jot e pranishme dhe jo dakord .

6.2 Cdo ortak k ate drejte te marre pjese ne mbledhje e asamblese dhe disponon nje numer votash te barabarte me pjeset e kapitalit themeltar qe ai zoteron. Cdo ortak k ate drejte te perfaqesohet nga Asambleja nga persona te trete duke u leshuar atyre proKure te posacme per cdo mbledhje te asamblese me te drejte vote dhe vendimarrje

6.3 Vendimet ne mungese te prezences se ortakeve mund te merren pas konsultimit me shkrim te tyre, ne rast se te gjithe ortaket miratojne me shkrim permajtjen e konsultimit. Ne kete rast, zbatohen procedurat e percaktuar nga ligji tregtar

6.4 Ortaket lajmerohen per zhvillimin e mbledhjes se asamblese me shkrese aqpo me mesazh elektronik, I cili duhet te permbate vendin, daten, oren e mbledhjes he rendin e dites jo me vone se 7 dite perpara dates se mbledhjes.

6.5 Mledhja e asamblese mund te thirret nga Administratori I shoqerise, nga nje ose disa prej ortakeve te shoqerise qe zoterojne te pakten 5% te pjeseve te kapitalit themeltar.

6.6 Cdo mbledhje e asamblese e thirrur ne menyre te parregullt, mund te anullohet . Anullimi nuk ka vlere, ne rast se te gjithe ortaket jane te pranishem ose te perfaquesuar

Neni 7

Kompetencat e Asamblese se Pergjithshme

7.1 Asambleja e Pergjithshme, pervec te tjerash, eshte I vetmi organ qe vendos per:

- Emerimin ose shkarkimin e administratoreve,eksperteve kontabel te autorizuar dhe likuiduesve
- Percaktimin e shperblimeve per administratorin , ekspertin kontabel dhe likuiduesve
- Percaktimin e politkave tregtare te shoqerise
- Mbikqyrjen zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire perqatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te te ecurise se veprimtarise
- Miratimin e raporteve te administrimit dhe te kontrrollit
- Miratimin e llogarive vjetore,disponimin e fitimin, etj
- Ndryshimet e statutit
- Zmadhimi ose zvogelimi I kapitalit themeltar
- Pjesetimin e kuotave dhe annullimin e tyre
- Pefaqesimin e shoqerise ne Gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve
- Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise
- Miratimin e rregullave procedural te mbledhjeve te asamblese
- Transferimin e pjeseve te kapitalit themeltar tek te tretet

- Zgjatjen e kohes se veprimtarise se shoqerise apo prishjen e saj dhe kalimin ne process likuiditeti
- Shnderrimi I shoqerise me perjegjesi te kufizuar ne forma te tjera
- Etj

Neni 8

Kuorumi

8.1 Asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme ne qofte se jane te pranishem ose te perfaqesuar nga nje ose disa ortak qe zoterojne 30% te pjeseve te kapitalit themeltar. Ne rastet kur Asambleja e Pergjithshme duhet te vendose per ceshtje si: ndryshimin e statutit , zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te rregjistruar, shperndarja e fitimeve , riorganizimi dhe prishjen e shoqerise, shitja e kuotave , ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese ortaket e shoqerise themeluese jane te te gjithe te pranishem dhe vendimarrja te jete unanime

8.2 Ne qofte se Asambleja e Pergjithshme nuk realizohet per mungese kuorumi , thirret asambleja e dyte brenda 30 diteve me te njejtin rend dite. Edhe ne kete rast vendimet jane te vlefshme merren nese formalizuar kuorumi I nevojshem ne varesi te ceshtjes rend dite te percaktuar

8.3 Ndryshimet e statutit, transferimi I pjeseve te kapitalit themeltar tek te tretet, zmadhimi ose zvogelimi I kapitalit te rregjistruar shperndarja e fitimeve , riorganizmi apo prishja e shoqerise dhe kalimi ne proces likuidimi, shnderrimi ne nje forme tjeter, vendosen ne mbledhjen e asamblese vetem kur kuorumi I kerkuar perbehet nga te gjithe ortaket e shoqerise ECO CASA sh.p.k dhe vendimarrja te jete unanime

8.4 Asambleja drejtohet nga nje anetar I zgjedhur nga ortaket e pranishem. Te gjitha vendimet e Asamblese transkriptohen dhe ruhen ne rregjistra te shoqerise. Ne rast te percaktuara ne ligj,vendimet e asamblese duhen te rregjistrohen ne QKB

Neni 9

Kompetencat e Administratoreve

9.1 Ortaket bien dakord qe Administratori i shoqerise "ECO CASA" sh.p.k te caktohet znj. Malvina Lika, me nr.personal I85910006N, tel, 00355676054632, email.
avokatmalvinalika@gmail.com

9.2 Afati I ketij mandati fillon me rrregjistrimin e ketoj Statuti dhe Akt themelimi ne Qendren Kombetare te Rregjistrimit dhe vazhdon per pese vjet me te drejte rizgjedhjeje

Neni 10

Kompetencat e Administratorit



10.1 Administratori drejton te gjithe veprimtarine e Shoqerise nga pikepamja tekniko-organizative, ka te gjitha kompetencat per te vendosur ne lidhje me aktivitetin e zakonshem dhe te perditshme te shoqerise. Administratori zbaton vendimarrjet e asamblese se per gjithshme per ceshjet e permendura ne nenin 7, gezon te drejta te plota vendimarrje dhe gezon te drejta te plota edhe ne raport me te tretet ne emer e perllogari te kompanise

10.2 Te Drejtat dhe Detyrimet e Administratoreve te shoqerise

- Te kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare te vendosura nga asambleja e per gjithshme.
- Të përfaqësojnë shoqerinë tregtare ne cdo veprimtari me te tretet
- Të përfaqësojnë shoqerinë tregtar dhe te veproje ne emer e perllogari te saj ne cdo fushe te aktivitetit, ne cdo institucion privat apo public, ne cdo shkalle gjykimi ne gjykate ne cdo marredhenje me persona te trete fizike apo juridik, e lidhe cdo kontrate qe eshte ne sherbim te shoqerise
- Ka te drejte te hape e te mbylle llogari bankare ne cdo banke te nivelist te dyte ne emer e perllogari te kompanise , te depozitoje shuma e te terheqe shuma per perllogari te administrimit te kompanise
- Të kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- Të përgatisin dhe të nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe reportin e ecurisë së veprimtarisë, të cilët ia paraqesin këshillit të administrimit për miratim, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, për t'u paraqitur më pas për miratim nga asambleja e përgjithshme
- Të krijojnë një sistem monitorimi e njoftimi të hershëm për rr Ethanat, që kërcënojnë ekzistencën e shoqërisë;
- Të kryejnë regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të shoqërisë, sipas parashikimeve të këtij ligji apo të ligjeve të tjera
- Të raportojnë përpara këshillit të administrimit për zbatimin e politikave tregtare dhe, me realizimin e veprimeve me rëndësi të veçantë, për veprimtarinë e shoqërisë
- Per te gjitha punimet e sherbimet e tjera te planifikuara me pare ne sherbime dhe mirembajtje te vepres do te veproje sipas vendimit te asamblese se per gjithshme
- Të kryejnë detyra të tjera, të përcaktuara në ligj dhe në statut

Neni 11

Ekspertet kontabel te autorizuar



Ne rast se Asambleja e Pergjithshme e gjykon te arsyeshme ose nese kerkohet ne menyre te shprehur nga ligji , konrrrolli ishoqerise kryhet nga nje ekspert kontabel I autorizuar. Shkarkimi I ekspertit kontabel te autorizuar vendoset me te njejtë kushte si emerimi

KREU III
MJETE E SHOQERISE , KAPITALI , KUOTAT
NENI 12

KAPITALI THEMELTAR

- 12.1 Kapitali themeltar i shoqerise "ECO CASA" sh.p.k eshte 10,000.00 leke (dhjete mijë leke)
- 12.2 Kapitali perbehet nga 2 kuota, ku vlera e cdo kuote eshte 5,000.00 (pese mijë) leke secila
- 12.3 Kontributet e ortakeve te shoqerise ne kapitalin themeltar jane si me poshte vijon:

Ortaket themelues te shoqerise do te jete si me poshte:

- a.Ortaku themelues Cherubino Battaglia , zoterues i 1(nje) kuote me vlore 5,000.00 leke (pese mijë leke), qe perben 50% te kapitalit themeltar te shoqerise
- b.Ortaku themelues Sokol Dallaku, zoterues i 1 (nje) kuote, me vlore 5,000.00 leke (pese mijë leke), qe perben 50% te kapitalit themeltar te shoqerise

Neni 13

KUOTAT E KAPITALIT

- 13.1. Kuotat e kapitalit themeltar jane emerore dhe te transferueshme .

13.2 . Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet: a) kontributit në kapitalin e shoqërisë; b) shitblerjes; c) trashëgimisë; ç) dhurimit, ne rast ndarjeje pasurore mes bashkeshorteve dhe nepermjet paraadhesve dhe pasardhesve

13.3 Pjeset e kapitalit themeltar mund tu transferohen te treteve me ane te shitjes vetem pasi te jene ofruar me pare per blerje ortakeve te tjere te shoqerise, duke respektuar te drejten e tyre te parablerjes, me miratimin unanim te ortakeve te shoqerise themeluese., dhe me kushte jo me te favorshme se ato me te cilat ju jane ofruar me pare ortakeve te tjere. Ne rastin kur nga ortaket e shoqerise, kerkon te transferoje me ane te dhurimit, tek nje ose disa ortake te shoqerise apo tek



Bektira Bajraktari

persona te trete, pjesa te kapitalit t tij themeltar ,mund ta beje kete duke marre pelqimin paraprak te ortakeve te tjere

NENI 14

FONDET E SHOQUERISE

14.1 Shoqeria kryen veprimtarine e saj me mjete te investuara ne fondet e saj dhe me mjete te tjera. Ajo eshte e detyruar qe vellimin e punes se saj ta ushtroje ne varesi me shume mjete te investuara ne fondin themeltar te Shoquerise dhe nga shuma e mjeteve te rezerves

Shoqeria percakton fondet e meposhtme:

1. Fondin themeltar
2. Fondin reserve

14.2. Per ushtrimin e veprimtarise se saj shoqeria mund te percaktoje dhe fonde te tjera

Neni 15

15.1 Fondi themeltar formohet nga mjete te investuara nga ortaku dhe nga mjete te tjera ne para ose ne forme tjeter te investuara

15.2 Shoqeria shfrytezon fondin themeltar per ushtrimin e veprimtarise se saj, per investime ne fonde e personave te tjere juridik dhe fizik si dhe per te perballuar rreziqet pas shfrytezimit te mjeteve te rezerves

15.3 Gjithashtu,mund ti shfrytezoje edhe per destinacione te tjera sipas interesit te shoquerise

Neni 16

Fondi reserve

Fondi reserve i shoquerise perbehet nga nje pjesa fitimit qe shoqeria realzion gjate veprimtarise se saj. Ai percaktohet me nje vendimte vecante te asamblese se ortakeve themelues, apo fondi reserve mund te perdoret edhe per destinacione te tjera qe jane ne perputhje me interest e shoquerise.

Kreu 4

Viti finanziar, llogarite vjetore, ndarja e fitimeve , dividentet

Neni 17

Viti finanziar

17.1 Cdo vit finanziar fillon me date 1 Janar e perfundon me date 31 Dhjetor

17.2 Llogaria vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit dhe eventualisht nga eksperti kontabel I autorizuar , miratohet nga asamb;leja me shumice e ortakeve qe zoterojne mbi $\frac{1}{2}$ e kapitalit themeltar

17.3 Miratimi I dokumentave mbi veprimtarine vjetore behet brenda nje afati te caktuar prej 6 muajsh nga data e mbylljes se vitit finanziar.

Neni 18

Llogarite financiare

18.1. Ne fund te cdo viti kalendarik duhet te hartohet nje bilanc si dhe nje llogaritje e fitimeve dhe humbjeve. Me kete duhet te ngarkohen eksperte, fitimi ishoqerise ndahet si me poshte:

18.2. 5% merren si reserve ligjore nga rezerva deri sa te jene arritur ne 20% te kapitalit themeltar,

18.3. Shuma e mbetur ndahet midis ortakeve sipas pjeseve te tyre ne shoqeri.

18.4. Forma e bilanceve dhe librave te llogarise qe do te mbaje shoqeria, percaktohet nga asambleja e Pergjithshme.

Neni 19

19.1 pas miratimit te llogarive vjetore dhe evidentimi te ekzistences se fitimeve, asambleja e Pergjithshme percakton pjesen qe u takon ortakeve ne formen e dividentit. Fitimi qe do te ndahet midisi ortakve ne proporcion me pjesen e kapitalit themeltar, perbehet nga fitimi I vitit finanziar, te cilet jane zbritur shumat e lena menjane per fondin reserve te domosdoshme (5% e fitimit te cdo viti deri sa ky fond te arrije ne vleren 1/10 e kapitalit themeltar dhe nga ana tjeter I jane zbritur ose shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbarturanga vitet e meparshme

KREU V

KUFZIMI I AFATIT, PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE

Neni 20

NDRYSHIMET E AFATIT

20.1 kufizimi apo zgjatja e afatit te veprimtarise se shoqerise mund te vendoseet nga asambleja e ortakeve me shumicen e ortakve qe zoterojne mbi $\frac{3}{4}$ e kapitalit themeltar

Neni 21

PRISHJA E SHOQERISE

- 21.1. shoqeria prishet ne perputhje me kushtet e percaktuara ne kete statuit, me vendim te asamblese se Ortakve me kerkesen e $\frac{3}{4}$ te pjesemarrjes ne kapitalin themeltar.
- 21.2 shkaqet e prishjes se shoqerise
- a. kur mbaron kohezgjatjha e percaktuar ne themelimin e saj
 - b. me vendimin e Asamblese se Pergjithshme
 - c. me hapjen e procedurave te falimentimit
 - d. nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per 2 vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi I veprimtarise ne Q.K.R
 - e. me vendim Gjykate

shoqeria nuk prishet kur njeri nga ortaket falimenton, bejet I paafte ose vdes

NENI 22

LIKUIDIMI I SHOQERISE

22.1 SHoqeria hyn ne procesin e likuidimit qe ne momentin e prishjes se saj. Per kryerjen e ketij procesi Asambleja emeron nje ose disa likuidues te cilet I paraqesin atij reportin mbi gjendjen e aktivit dhe te pasivit te shoqerise, mbi ndjekjen e operacioneve te likuidimit dhe mbi afatin e domosdoshem te perfundimit te tyre.

22.2 ne fund te procesit te likuidimi te Asamblese me shumicen e ortakeve qe zoterojne mbi $\frac{3}{4}$ e kapitalit themeltar vendos mbi bilancin perfundimtar financier, mbi aktin e rregullshmerise te punes se likuiduesit dhe mbylljes se procesit te likuidimit

22.3 pas pagimit te kreditoreve dhe shlyerjes se pjeseve te kapitalit themeltar tek kontribuesit perkates , likuiduesi ndan kapitalet e mbeturia ndermjet ortakeve ne proporcion me pjeset qe ata zoterojne ne kapitalin themeltar dhe njofton Q.K.E per perfundimin e likuidimit dhë kerkon crrегистrimin e Shoqerise

KREU VI

DISPOZITAT E FUNDIT

NENI 23

SHNDERRIMI I SHOQERISE

23.1. Shnderrimi I shoqerise me perjegjesi te kufizuar ne shoqerine aksionare mnd te kryhet me miratimin e shumices se ortakeve qe zoterojne mbi $\frac{3}{4}$ e kapitalit themeltar

23.2 Marredhenjet e brendshme ndermjet punetoreve dhe shoqerise midis tyre dhe organeve te shoqerise do te rregullohen me ane te nje rregulloreje.

NENI 24

INTERPRETIMET STATUTORE

23.1 Pavlefshmeria e dispozitave te vecanta te kesaj marreveshjeje nuk e prek teresine e saj vepruese. Ne vend te dispozitave te pavlefsme ose per perm bushjen e hapesirave statutore, ortaket bien dakord per nje rregullim te pershtatshem, ne perputhje me qellimin e hartimit te ketij statute, duke ruajtur interest e perbashketa.

23.2 Per gjithcka jot e parashikuar ne kete statut do te respektohen normat ligjore te legjispcionit shqiptar ne fuqi.

23.3 Gjykata kompetente per zgjidhjen e te gjitha mosmarrveshjeve qe mund te lindin gjate ekzistences se shoqerise ose gjate periudhes se likuidimit, ndermjet shoqerise dhe ortakve , apo ndermjet shoqerise dhe te treteve do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor ,Tirane

23.4 Ky statut hartohet me 4 ekzemplare original, hyn ne fuqi diten e nenshkrimit te ketij statuti

NENI 25

DISPOZITAT E FUNDIT

24.1 Per te gjitha ceshtjet qe nuk gjejne rregullim ne kete statut aplikohen dispozitat e ligit nr.9901 date 14.04.2008 ' Per tregtaret dhe shoqerite tregtare' (I ndryshuar

24.2 Per efekt te interpretimit te ketij statute me ligj tregtar do te nenkuptohet ligji nr.9901 date 14.04.2008 'Per trregtaret dhe shoqerite tregtare' (I ndryshuar)

24.3. Pavlefshmeria eventuale e dispozitave te vecanta teStautit nuk mund te cenojn e vlefshmerin ne teresine e saj

Ortaket themelues

Cherubino Battaglia

CHERUBINO BATTAGLIA

Battaglia

Sokol Dallaku

SOKOL DALLAKU

Sokol